



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kacanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik-
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 16-36419/14
Kaçanik, 30.12.2014

Në bazë të nenit 40.2(d) të Ligjit Nr. 03L-/040- Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare nr. 28 e datës 04 qershor 2008), të neneve 34.5 dhe 36 lidhur me nenet 40, 41 dhe 42 të Statutit të Komunës, të nenit 15(c) lidhur me nenin 24 të Rregullores për Punë të Kuvendit, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 30.12.2014, merr këtë:

V E N D I M
PËR APROVIMIN E PLANIT I PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS
KAÇANIK PËR VITIN 2015

I.

Me këtë Vendim, Aprovohet Plani i Punës së Kuvendit të Komunës Kaçanik, për vitin 2015.

II.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në vitin 2015, planifikon t'i mbajë gjithsej, 10 Mbledhje të Rregullta.

III.

Mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës, do të mbahen sipas këtij Plani të Punës:

PLANI I Mbledhjeve të Kuvendit

	Numri i mbledhjeve	Periudha Kohore	Vendi i mbajtjes	Ora	Rendi i Punës	Kryesimi i mbledhjeve
1	2	3	4	5	6	7
01.	Mbledhja e I-ë	Javën e fundit të muajit janar	Katin e III-të në Sallën e Kuvendit	11:00	<p>1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e XI e kuvendit të komunës, për vitin 2014;</p> <p>2. Plani i Punës së Ekzekutivit të komunës për vitin 2015;</p> <p>3. Plani i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2015;</p> <p>4. Propozim Rregullorja për ndryshim plotësimin e rregullores për caktimin e orarit të punës së subjekteve afariste;</p> <p>5. Propozim Vendimi dhe Drafti me Pasqyrat Financiare –Për bartjen e bilanceve të pashpenzuara nga viti 2014 në vitin 2015;</p> <p>6. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për ndryshime eventuale të Planit të parcelimit dhe riparcelimit sipas PRRU;</p> <p>7. Propozim Vendimi për formimin e komisionit për hartimin e Rregullores për ndarjen e bursave për studentë të komunës së Kaçanikut; dhe</p> <p>8. Plani i Aktiviteteve të grupit të grave, për vitin 2015.</p>	Kryesuesi i KK
02.	Mbledhja e II-të	Javën e fundit të muajit shkurt	- "-	11:00	<p>1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e I-ë e Rregullt e Kuvendit të Komunës, për vitin 2015;</p> <p>2. Propozim Rregullorja për caktimin e kushteve ndërtimore;</p> <p>3. Raporti i Punës së Komitetit për Politikë dhe</p>	- "-

					<p>Financa (KPF-a), për vitin 2014; 4. Raporti i Punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2014; 5. Raporti i Punës së Ekzekutivit të komunës për vitin 2014; 2.Raporti final financiar i komunës për vitin 2014.</p>	
03.	Mbledhja e III-të	Javën e fundit të muajit mars	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e II-të e Rregullt e kuvendit të komunës; 2. Propozim Vendimi për përpilimin e hartave Zonale per komunën e Kaçanikut; 3. Propozim Vendimi për destinimin e mjeteve financiare për realizimin e projekteve të DBPZHR të parapara me buxhetin e vitit 2015; 4. Propozim Vendimi për ndryshimin e destinimit të ngastrave kadastrale ne fsh Bob afër Palestrës sportive; dhe 5.Shqyrtimi i Raporteve të Komisioneve të aksionarëve për punën e ndërmarrjeve publike.	--
04.	Mbledhja e IV-të	Javën e fundit të muajit prill	--	11:00	1.Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e III-të e rregullt e kuvendit të komunës; 2.Propozim Vendimi për formimit te komisionit per rishikimin e destinimit te disa zoneve urbane rurale ne PZHK; 3. Raporti tremujorë për realizimin e mjeteve buxhetore për periudhën: janar-mars, 2014.	--
05.	Mbledhja e V-të	Javën e fundit të muajit maj	--	11:00	1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e IV-të e rregullt e kuvendit të komunës; 2. Propozim Vendimi për caktimin e zonës me interes publik – vazhdimi i rrugës “Ismail Raka”	--

					<p>deri te "Xhamia e Deshmoreve " dhe hapsirës ndërmjet rr. Besnik Beguca dhe lumit Nerodime – Shtëpia e Kulturës-Xhamia e Dëshmoreve.</p>	
06.	Mbledhja e VI-të	Javën e fundit të muajit qershor	11:00	--	<p>1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e V-të e Rregullt e kuvendit të komunës; 2. Propozim Vendimi dhe Pasqyrat Financiare për Rishikimin Gjastëmujor të Buxhetit të komunës për vitin 2015; 3. Korniza Afatmesme Buxhetore për vitet 2016-2018.</p>	--
07.	Mbledhja e VII-të	Javën e fundit të muajit korrik	11:00	--	<p>1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VI-të e rregullt e kuvendit të komunës; 2. Raporti për realizimin e mjeteve buxhetore, për periudhën, Janar-Qershor, 2015; 3. Raporti i Auditorit të Përgjithshëm për komunën e Kaçanikut për vitin 2014.</p>	--
08.	Mbledhja e VIII-të	Javën e fundit të muajit shtator	11:00	--	<p>1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VII-të e rregullt e kuvendit të komunës; 2. Propozim Vendimi për Rregullimet buxhetore nga ndarjet me buxhetin e komunës, për vitin 2015; 3. Draft - Buxheti i komunës për vitin 2016 dhe vlerësimet për periudhën e viteve, 2017-2018; 4. Propozim-Rregullorja për vendosjen e Tatimit në Pronë, në territorin e komunës së Kaçanikut, për vitin 2016; 5. Propozim Vendimi për miratimi e taksave dhe tarifave ndërtimore; dhe 6. Informatë e Drejtorisë së Arsimit për përfundimin e vitit shkollor, 2014/2015.</p>	--

09.	Mbledhja e IX-të	Javën e fundit të muajit tetor	--	11:00	<p>1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e VIII-të e rregullt e kuvendit të komunës;</p> <p>2. Informatë për pengaditjet dimërore për mirëmbajtjen e rrugëve lokale; dhe</p> <p>3. Raporti për realizimin e mjeteve buxhetore, për periudhën, Janar-Shtator 2015.</p>	--
10.	Mbledhja e X-të	Javën e fundit të muajit nëntor	--	11:00	<p>1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e IX-të e rregullt e kuvendit të komunës;</p> <p>2. Propozim Vendimi për miratimin e Hartave Zonale;</p> <p>3. Plani i Punës së Ekzekutivit të Komunës, për vitin 2016; dhe</p> <p>4. Plani i Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016.</p>	--

IV.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në muajin shtator do të mbajë dëgjim publik me qytetarë për çështjen e Draft-buxhetit të komunës për vitin 2016 dhe projeksionet për vitet: 2017-2018, para se të aprovohet drafti i buxhetit në kuvend.

V.

Kuvendi i Komunës Kaçanik, gjat vitit 2015, mund të mbajë edhe mbledhje tjera të Rregullta më me shumë se minimumi i paraparë me aktet në fuqi. Të gjitha mbledhjet e Rregullta do të mbahen vetëm ditëve të punës.

VI.

Materialet që i adresohen Kuvendit të Komunës, janë kryesisht çështje të propozuara nga ekzekutivi i komunës, e që kalojnë procedurën e shqyrtimit dhe aprovimit të KPF-a, dhe të njëjtat, me Rekomandim të KPF-a i kalojnë Kuvendit të komunës për shqyrtim dhe miratim apo në procedurë të mëtejme.

VII.

Të gjitha mbledhjet e Rregullta të KK do të jenë hapura për qytetarë dhe përfaqësuesë të mediave publike. Nese ndonjë mbledhje e Rregullt apo pjesë e mbledhjes do të mbahet me dyer të mbyllura, atëherë për këtë duhet të vendosë Kuvendi i Komunës. Nese mbledhja mbahet me dyer të hapura, në mbledhjet mund të marrin pjesë qytetarë të komunës dhe përfaqësuesë të mediave në përputhje me kushtet dhe mundësitë fizike.

VIII.

Njoftimet për mbledhje të Kuvendit të Komunës bëhen publike. Materialet për Mbledhjet e Rregullta të Kuvendit të Komunës iu dërgohen anëtarëve të Kuvendit të Komunës 7 ditë para mbajtjes së mbledhjes. Njoftimet dhe Materiali i mbledhjes i dërgohet edhe Kryetarit të komunës dhe Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

IX.

Kuvendi i Komunës për gjatë muajit gusht do të jetë në Pushim Vjetorë. Për fillimin dhe mbarimin e pushimit, kuvendi i komunës do të njoftohet paraprakisht. Për gjatë pushimit nuk planifikohet mbajtja e ndonjë mbledhje përveç nëse paraqitet ndonjë çështje eventuale, atëherë nuk përjashtohet mundësia të mbledhet Kuvendi i Komunës.

X.

Plani i përcaktuar i Kuvendit të komunës, është orientues e nuk do të thot se nuk pëson ndryshime varësisht nga kërkesat dhe nevojat që paraqiten.

Kryesuesi i Kuvendit,
Xhelal Gashi

